



Duke u mbështetur në nenin 12.2 nën d) të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale nr. 03/040, si dhe nenit 3 të Rregullores QRK nr.23/2013, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e III-të të punës për vitin 2018, të mbajtur më 30.03.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për

Formimin e Komisionit të Ankesave lidhur më shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës Komunale të paluajtshme në shfrytëzim

I

Formohet Komisioni i ankesave lidhur më shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

II

Komisioni si në pikën 1 të këtij Vendimi përbëhet nga 5 anëtarë, 2 (dy) nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, 2 (dy) nga Ekzekutivi i Komunës dhe 1(një) nga Shoqëria civile.

Anëtarët e këtij Komisioni janë:

1. Besart Hoti-KK
2. Brahim Mehmetaj-KK
3. Ajet Sejdiu –Ekzekutivi
4. Njomza Grabanica - “
5. Tahire Gashi-OJQ

III

Komisioni punën e tij e kryen konform dispozitave Ligjore dhe Rregulloreve në fuqi që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

IV

Ky vendim shfuqizon vendimin 01Nr.06-1548 të datës 10.03.2014.

V

Vendimi është i plotfuqishëm 15 ditë pas dërgimit në Autoritetin Mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të LVL dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqën e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01 Nr. 060-2027 2018
Klinë, më 05.10.9 2018

